



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE



V E N D I M

Nr. 22, datë 13.1.2022

P Ë R

**PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË NDËRTHESAVE,**  
**QË PËRJASHTOHEN NGA DETYRIMI I PIKËS SË AKSESIT**  
**PËR INFRASTRUKTURËN E RRJETEVE TË KOMUNIKIMEVE**  
**ELEKTRONIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 20, të ligjit nr 120/2016, "Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përcaktimin e kategorive të ndërthësive, që përjashtohen nga detyrimi për të pasur pikë aksesi në godinë për infrastrukturën e rrjeteve të komunikimeve elektronike, sipas shtojcës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen autoritetet planifikuese qendrore dhe vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**

**Në mungesë dhe me porosi**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**ARBEN AHMETAJ**

**MINISTRI I INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË**

**BELINDA BALLUKU**

**Në mungesë dhe me porosi**

**ZËVENDËSMINISTRI**

**ILIR BEJTJA**



**KATEGORITË E NDËRTESAVE QË PËRJASHTOHEN NGA DETYRIMI  
PËR PIKËN E AKSESIT PËR INFRASTRUKTURËN E RRJETEVE  
TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE**

Kategoritë e ndërtesave që përjashtohen nga detyrimi për të pasur pikë aksesit në godinë për infrastrukturën e rrjeteve të komunikimeve elektronike janë, si më poshtë vijon:

1. Ndërtesat në përdorim të Ministrisë së Mbrojtjes dhe/ose forcave ushtarake, ndërtesat e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, portet, aeroportet, si dhe godinat në përdorim për qëllime të sigurisë kombëtare.
2. Ndërtesat që përfshihen në listën e monumenteve kulturore apo që ndodhen në qendra, në zona dhe në parqe arkeologjike, në zona të mbrojtura në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi, kur ndërtimi i pikës së aksesit në godinë mund të ndryshojë në mënyrë të papranueshme karakterin ose pamjen e tyre.
3. Ndërtesa në zona të izoluara e të largëta, ku perspektiva për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë nuk e justifikon pajisjen e godinës me infrastrukturë fizike të gatshme për komunikime elektronike me shpejtësi të lartë ose me një pikë aksesit.
4. Ndërtesa që shërbejnë si hangarë, stalla, pulari, sera bujqësore, garazhe, magazina apo godina të vogla të shërbimeve, që nuk sigurojnë shërbime të fjetjes.
5. Përjashtimi për ndërtesat e përmendura në pikën 2, të kësaj shtojce, do të aplikohet edhe në rastet e miratimit të lejeve për punime të rikonstruksioneve, të restaurimeve në një godinë biznesi apo banimi kur investimi për pikën e aksesit në godinë është i lartë dhe nuk justifikohet kundrejt totalit të investimeve për punimet e rinovimit e nuk përbën përfitim shtesë për individin apo për bashkëpronarët e ndërtesës.

NR.PROT. 174/1  
DATË 16.1. 2022

TË GJITHA MINISTRIVE  
TË GJITHA BASHKIVE  
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

**Sekretari i Përgjithshëm**

**Engjëll AGAÇI**

